



PROJEKT - VENDIM

Nr. 100 Datë 16.07.2012

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI ASHTA” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2, gërma “ a ” ; 9, dhe nenit 45 pika “4”, dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “ f ”, 5 pika 1 gërma “ f ” dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.06.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ENERGJI ASHTA” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “ENERGJI ASHTA” sh.p.k” plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germet “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “ENERGJI ASHTA” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI